

L I G J
Nr.9575, datë 3.7.2006

**PËR FALJEN E GJOBAVE TË KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, SI DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA
PUNËSIMI PËR PERSONAT JURIDIKË E FIZIKË, TË REGJISTRUAR SI TATIMPAGUES TË
TAKSËS VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL, PËR PERIUDHAT TATIMORE TË VITIT 2005**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, u falen gjocat e vendosura, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarimin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me kusht që deklarimi dhe pagesa të bëhen brenda datës 31.12.2006.

Neni 2

Personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, u rimbursohet shuma e gjobave të paguara, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarimin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Neni 3

Çështjet në proces apelimi dhe çështjet për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që lidhen me gjocat e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, pushohen.

Subjektet shtetërore kreditore detyrohen që, në përputhje me shkronjën "b" të nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesin pranë organeve të përmbarimit kërkesë për pushimin e ekzekutimit.

Neni 4

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji të gjitha institucionet shtetërore, të prekura nga fusha e zbatimit të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4991, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu